



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica - Municipality of Gjakova

ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARHIVE
OUTPUT ARCHIVES

Nr. Invi/Br. Invi 01-011/01-16681 Nr.faqeve/Br. Str./No. Pg. 1
Data/Datum/Date 01.11.2024
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

RREGULLORE
PËR
NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN
E RREGULLORES 01 NR.110/04-29368 PËR TAKSA KOMUNALE .

Gjakovë
Tetor 2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____/2024

Dt.30.10.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), lidhur me nenin 17 paragrafi 1 shkronja c), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28/2008), në mbështetje të Kreut II dhe Kreut III të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 27/2008, 03 Qershor 2008), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2016, 03 Gusht 2018), me datë 30.10.2024, pas diskutimeve lidhur me pikën e 5 të rendit të ditës: Shqyrtimi i Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale miratoi këtë:

**Rregullore për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores 01nr.110/04-29368 të datës
28.12.2022 për Taksa Komunale**

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e “Rregullores 01nr.110/04-29368 për Taksa Komunale”, (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Neni 2

1. Neni 7 paragrafi 1 i Rregullores bazike, ndryshohet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:
2. Të gjithë personat që pajisen me certifikata zyrtare dhe dokumente tjera zyrtare nga Komuna, paguajnë taksë komunale, si në vijim:
 - 2.1 Certifikata e lindjes – një euro (1 €);
 - 2.2 Ekstrakti i lindjes - një euro (1 €);
 - 2.3 Certifikata e shtetësisë - një euro (1 €);
 - 1.4 Certifikata e martesës - një (euro 1 €);
 - 1.5 Certifikata e vendbanimit apo e vendqëndrimit - një euro (1 €);
 - 1.6 Certifikata e gjendjes martesore - një euro (1 €);
 - 1.7 Certifikata e vdekjes - një euro (1 €);
 - 1.8 Certifikata e bashkësisë familjare - një euro (1 €);
 - 1.9 Certifikata mbi vërtetimin e arkivit – tre euro (3 €)
 - 1.10 Akti i vdekjes - pesë euro (5 €);
 - 1.11 Vërtetim mbi mjetet e jetesës - dy euro (2 €);

- 1.12 Vërtetim që personi është në jetë - një euro (1 €);
- 1.13 Vërtetim për lajmërim apo ç'lajmërim të vendbanimit – Pa pagesë;
- 1.14 Vërtetimi që personi nuk është regjistruar në regjistrat civil – Pa pagesë.

Neni 3

1. Neni 10 paragrafi 1 i Rregullores bazike, ndryshohet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:
2. Të gjithë personat që pranojnë shërbime të caktuara komunale paguajnë taksë komunale administrative, si në vijim:
 - 2.1. Kurorëzimi brenda objektit të komunës, brenda orarit të punës – dhjetë euro (10 €);
 - 2.2. Kurorëzimi brenda objektit të komunës, jashtë orarit të punës – njëzetë euro (20 €);
 - 2.3. Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, brenda orarit të punës – njëzetepesë euro (25 €);
 - 2.4. Kurorëzimi jashtë objektit të komunës, jashtë orarit të punës – njëqind euro (100 €);
 - 2.5. Korrigjimi i emrit personal (germëzimi) – tre euro (3 €)
 - 2.6. Ndryshimi i emrit personal – pesëdhjetë euro (50 €);
 - 2.7. Ndryshimi i emrit personal për personat nën moshën 16 vjeçare – njëzetë euro (20 €)
 - 2.8. Ndërrimi i mbiemrit pas anulimit të martesës pesë euro (5 €);
 - 2.9. Anulimi i dyfishtë i regjistrimit në gjendjen civile pesë euro (5 €);
 - 2.10. Kërkesa për procesverbale të ndryshme - pesë euro (5 €);
 - 2.11. Legalizimi i dokumenteve në bazë të origjinalit (për një faqe) – pesëdhjetë cent (0.50 €);
 - 2.12. Leja mbi varrimin – Pa pagesë;
 - 2.13. Inspektimi final në fushën e ndërtimit për personat fizik dhe juridik – dhjetë euro (10 €)
 - 2.14. Kërkesa për mbikëqyrje të asgjësimit të produkteve ushqimore dhe joushqimore deri në 1500 kg/litër njëzetepesë euro (25 €), mbi 1500 kg/litër pesëdhjetë euro (50 €);
 - 2.15. Lëshimi i certifikatës së përdorimit – Pa pagesë;
 - 2.16. Lëshimi i pëlqimit urbanistik dhe dokumenteve tjera urbanistike – dhjetë euro (10 €);
 - 2.17. Lëshimi i vërtetimit mbi statusin ushtarak – pesë euro (5 €);
 - 2.18. Pajisja me Certifikatë/pëlqim sanitar në fushën e ndërtimit: Për 1 deri 100 m² -njëqind euro (100 €), Pagesa për 101 deri 1000 m² – pesëqind euro (500 €), Pagesa për 1001 deri 2000 m² - njëmijë 1000 euro (1000 €), Pagesa për mbi 2000 m² – dymijë euro (2000 €).
 - 2.19. Certifikatë që nuk është nën kujdestari (për mbajtje të armës) – pesë euro (5 €);
 - 2.20. Vërtetim për lirim nga shtetësia e Republikës së Kosovës – dhjetë euro (10 €);
 - 2.21. Vërtetimin për pranimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës - pesë euro (5 €);
 - 2.22. Vërtetim për Bashkim Familjar (Anamnezë Sociale) - dhjetë euro (10 €);
 - 2.23. Kërkesa nga palët për vlerësimin e dëmit – Pesë euro (5€).

Neni 4

1. Neni 12 paragrafi 1 i Rregullores bazike, ndryshohet dhe plotësohet si vijon:
2. Çdo shoqëri tregtare e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) që ndodhet dhe operon brenda territorit të Komunës, paguan taksë vjetore komunale siç është e përcaktuar në pikat e nenit 12 paragrafi 1 të rregullores bazë, përveç shoqërive tregtare që veprimtarinë afariste primare e ushtrojnë për prodhim, përpunim si dhe tregtim me pakicë.

3. Shoqëritë tregtare që veprimtarinë afariste primare e ushtrojnë për prodhim, përpunim dhe tregti me pakicë, paguajnë taksë komunale në vlerë prej pesëdhjetë (50 €) , ndërsa shoqëritë tjera tregtare paguajnë sipas rregullores bazë.

Neni 5

Pas nenit 19, shtohet neni i ri, si në vijim:

19A

Tarifa për pajisje me Leje Mjedisore Komunale

1. Aplikuesi duhet të paguajë për projektet:

- 1.1. Në vlerën investive të projektit deri në 25,000.00 euro (njëzetë e pesë mijë euro), paguhet tarifa prej 50.00 euro (pesëdhjetë euro).
- 1.2. Në vlerën investive mbi 25,000.00 euro (njëzetë e pesë mijë euro), paguhet tarifa 0.2% të vlerës investive finale konform parallogarisë së saktë në projekt, e që duhet të paraqitet në Raportin e Lejes Mjedisore Komunale.

Neni 6

1. Neni 26 i Rregullores bazike, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:
2. Çdo person që vendos objekte të ndryshme në hapësirat publike, paguan taksë komunale si në vijim:
 - 2.1 Vendosija e kiosqeve ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare në Zonën I – dhjetë euro për një metër katror (10 €/m²) në muaj;
 - 2.2 Vendosija e kiosqeve ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare në Zonën II – tetë euro për një metër katror (8 €/m²) në muaj;
 - 2.3 Vendosija e kiosqeve ose objekteve tjera montuese për veprimtari tregtare në Zonën III – gjashtë euro për një metër katror (6 €/m²) në muaj.
3. Çdo person që shfrytëzon hapësirën publike, paguan taksë komunale si në vijim:
 - 3.1 Vendosija e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike – që shfrytëzon hapësirën deri në 5 m², taksohet tetë euro për një metër katror (8 €/m²) në muaj;
 - 3.2 Vendosija e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike – që shfrytëzon hapësirën nga 5 deri 10 m², taksohet shtatë euro për një metër katror (7 €/m²) në muaj;
 - 3.3 Vendosija e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike – që shfrytëzon hapësirën nga 10 deri 30 m², taksohet gjashtë euro për një metër katror (6 €/m²) në muaj;

- 3.4 Vendorsja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike – që shfrytëzon hapësirën nga 30 deri 100 m², taksohet pesë euro për një metër katror (5 €/m²) në muaj;
 - 3.5 Vendorsja e tavolinave për shërbim para objektit ku ushtrohet veprimtaria ekonomike – që shfrytëzon hapësirën mbi 100 m², taksohet tri euro për një metër katror (3 €/m²) në muaj;
 - 3.6 Vendorsja e mallrave për ekspozim para hapësirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën I – pesëmbëdhjetë euro për një metër katror (15 €/m²) në muaj;
 - 3.7 Vendorsja e mallrave për ekspozim para hapësirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën II – dhjetë euro për një metër katror (10 €/m²) në muaj;
 - 3.8 Vendorsja e mallrave për ekspozim para hapësirës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike në Zonën III – pesë euro për një metër katror (5 €/m²) në muaj;
 - 3.9 Vendorsja e shtandeve të hapura për shitjen e librave jo shkollore për veprimtari ekonomike në Zonën I – njëzetë euro (20 €) në muaj;
 - 3.10 Vendorsja e shtandeve të hapura për shitjen e librave jo shkollore për veprimtari ekonomike në Zonën II – pesëmbëdhjetë euro (15 €) në muaj;
 - 3.11 Vendorsja e shtandeve të hapura për shitjen e librave jo shkollore për veprimtari ekonomike në Zonën III – dhjetë euro (10 €) në muaj;
 - 3.12 Vendorsja e pajisjeve për akullore dhe të ngjashme për veprimtari tregtare në Zonën I – pesëmbëdhjetë euro (15 €) në muaj;
 - 3.13 Vendorsja e pajisjeve për akullore dhe të ngjashme për veprimtari tregtare në Zonën II – dhjetë euro (10 €) në muaj;
 - 3.14 Vendorsja e pajisjeve për akullore dhe të ngjashme për veprimtari tregtare në Zonën III – tetë euro (8 €) në muaj;
 - 3.15 Vendorsja e automjetit lëvizës për shitjen e ushqimit të shpejtë – tridhjetë (30 €) në muaj;
 - 3.16 Vendorsja e tendave (çadrave) të hapura lëvizëse me mekanizëm – tetë euro për një metër katror për (8 €/m²) në muaj;
 - 3.17 Vendorsjen e lojërave të fëmijëve – tre euro për një metër katror (3 €/m²) në muaj;
 - 3.18 Vendorsja e gjeneratorëve statik – gjashtë euro për një metër katror (6 €/m²) në muaj;
 - 3.19 Vendorsja e veturave për qëllime komerciale – njëzetë euro (20 €) në muaj;
 - 3.20 Vendorsja e lojërave argëtuese – njëzetë euro (20 €) në muaj;
 - 3.21 Vendorsja e kabllave të ndryshme në hapësirë për qëllime komerciale private – njëqind euro (100 €) në vit;
 - 3.22 Vendorsja e kabllave të ndryshme nëntokësore për qëllime komerciale private – treqind euro (300 €) në vit;
 - 3.23 Vendorsja e ormanëve apo pajisjeve tjera shpërndarëse – njëqind euro (100 €) në vit;
 - 3.24 Vendorsja e foltoreve telefonike – njëqind e pesëdhjetë euro (150 €) në vit;
 - 3.25 Vendorsja e antenave telekomunikuese – treqind euro (300 €) në vit;
4. Objektet që nuk janë të përcaktuara në këtë rregullore, tarifa e tyre do të përcaktohet nga organi kompetent që lëshon pëlqimin për vendosjen e tyre në hapësirat publike. Kjo tarifë do të jetë ekuivalente me lartësinë e çmimit të objekteve që janë të përcaktuara me këtë rregullore.
 5. Institucionet publike dhe Organizatat jo qeveritare (OJQ) për vendosjen e objekteve të përkohshme në hapësirat publike dhe për shfrytëzimin e hapësirës publike deri në dhjetë ditë, pas dhënies së pëlqimit nga organet kompetente për zhvillimin e aktiviteteve në interes të përgjithshëm, lirohen nga taksat e përcaktuara sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 7

1. Neni 31 i Rregullores bazike, ndryshohet dhe riformulohet me tekstin si në vijim:
2. Çdo person që shfrytëzon objektet e brendshme dhe hapësirat e jashtme komunale për qëllime komerciale apo për qëllime tjera, paguan taksë komunale si në vijim:
 - 2.1. Salla e madhe e sporteve për klubet sportive, shkollat dhe OJQ-të që punojnë në rritjen e interesimit për sporte.– pesë euro (5 €/h) për një orë;
 - 2.2. Salla e madhe e sporteve, për rekreacion – njëzetë euro (20 €/h) për një orë;
 - 2.3. Trim kabineti për rekreacion – një euro për person (1 €/h) për një orë;
 - 2.4. Trim kabineti për rekreacion-njëzet euro për person (20 €/muaj) për një muaj;
 - 2.5. Mbajtja e tubimeve – Salla e Madhe-dyqind euro (200 €) Kohëzgjatje deri në 4 orë;
 - 2.6. Mbajtja e Tubimeve Elektorale – Salla e Madhe- treqind e pesëdhjetë euro (350 €)/1ditë;
 - 2.7. Mbajtja e Koncerteve – Salla e Madhe- Pesëqind euro (500 €)/1ditë;
 - 2.8. Zhvillimi i garave (ndeshjeve sportive)- pesë euro (5.00 €) Kohëzgjatje deri në 1 orë;
 - 2.9. Zhvillimi i garave (ndeshjeve sportive) që zhvillohen nga klubet të cilat nuk janë klube të Komunës së Gjakovës- njëqind euro (100 €) /për një ndeshje;
 - 2.10. Zhvillimi i garave (ndeshjeve sportive) në Sallën e madhe – njëqind euro (100€) /për një ditë
 - 2.11. Fusha e futbollit për rekreacion 1/1 (pa ndriçim)- pesëmbëdhjetë euro (15 €/h) për një orë;
 - 2.12. Fusha e futbollit për rekreacion 1/2 (pa ndriçim)- dhjetë euro (10 €/h) për një orë;
 - 2.13. Fusha e futbollit për shfrytëzimin e shkollave të futbollit- pesë euro (5 €/h) për një orë;
 - 2.14. Fusha e futbollit me ndriçim 1/1 – njëzetë euro (20 €/h) për një orë.
3. Shfrytëzimi i hapësirave të Pallatit të Kulturës “Asim Vokshi”, “Galeria e Arteve”, Biblioteka Publike “Ibrahim Rugova”, Salla “Teki Dervishi”.

Shfrytëzimi i hapësirave të Pallatit të Kulturës “Asim Vokshi”					
	Përshkrimi	Salla Universale	Salla Solemne	Salla e leximit	Hapësira e Foajesë
1.	Koncert – Shkolla Fillore dhe të Mesme, universitete - Private	100.00	n/a	n/a	100.00
2.	Koncert – 1 ditë e plotë	200.00	n/a	n/a	100.00
3.	Koncertet komerciale	100.00	n/a	n/a	n/a

4.	Debate, promovime, punëtori	150.00	50.00	30.00	50.00
5.	Debate, promovime, punëtori me përmbajtje ushqimore	n/a	n/a	50.00	70.00
8.	Grupet amatore dhe muzikore provat (deri në 3 orë)	20.00	10.00	10.00	10.00
9.	Shfrytëzimi i shtëpisë së Kulturës në fshatin Cërmjan	1 Ditë			20.00
10.	Shfrytëzimi i shtëpisë së Kulturës në fshatin Bishtazhin	1 Ditë			20.00

Galeria e Arteve			
11.	Debate, promovime, mbledhje, Trajnime/ Punëtori	1 Ditë	50.00
12.	Ekspozita / Hapja zyrtare për ekspozitë	Hapja zyrtare për ekspozitë	20.00
13.	Promovime, qëllime komerciale	1 Ditë	100.00

Shfrytëzimi i hapësirave të objektit të bibliotekës së qytetit për shfrytëzim nga subjektet tjera fitimprurëse dhe jofitimprurëse (që nuk i takojnë institucioneve publike)			
15.	Sallat e leximit për takime, punëtori, debate, trajnime, prezentime	Kohëzgjatja nën 4 orë	20.00
16.	Sallat e leximit për takime, punëtori, debate, trajnim	1 ditë	30.00
18.	Salla e leximit për shfrytëzim nga shkollat private fillore, të mesme, universitetet, kolegjet (për provime)	1 ditë	40.00
19	Regjistrimi i anëtarësisë Grupmoshat deri në klasën e tetë	1 vit	3.00

20	Regjistrimi i anëtarësisë Shkollarët e mesëm, ata që shërbejnë vetëm me një libër	1 vit	4.00
21	Regjistrimi i anëtarësisë Studentët	1 vit	6.00
Shfrytëzimi i hapësirave në sallën “Teki Dervishi”			
22	Trajnime / Punëtori, Shfaqje	1 ditë	20.00
23.	Qëllime komerciale (incizimi i spoteve, etj)	1 ditë	100.00
24.	Ekspozita	1 ditë	30.00
25.	Promovime, mbledhje, debate	1 ditë	20.00

Neni 7

1. Shfrytëzimi i hapësirave të muzeve (Muzeu Etnologjik, Muzeu Historik, Muzeu i Muzikës)

Shfrytëzimi i hapësirave të muzeve (Muzeu Etnologjik, Muzeu Historik, Muzeu i Muzikës)			
1.1	Trajnime / Punëtori	1 ditë	50.00
1.2	Qëllime komerciale (incizimi i spoteve, etj)	1 ditë	100.00
1.3	Ekspozita	hapja solemne + 10 ditë	50.00

2. Nga pagesa e për marrjen e shërbimeve, në Muzetë e Komunës së Gjakovës, në Bibliotekë, në Galerinë e Arteve dhe në Teatrin “Hadi Shehu” lirohen:

2.1 Në të gjitha Muzetë e Komunës së Gjakovës, lirohen vizitorët individ apo grupe të individëve.

2.2. Nga pagesa në Bibliotekë lirohen:

- 2.2.1 Anëtarët e familjeve të Dëshmorëve, Veteranëve, Invalidëve dhe Martirëve të luftës;
- 2.2.2 Personat me kushte të rënda sociale;
- 2.2.3 Kur janë tre e më shumë anëtarë të një familjeje (nga të njëjtit prindër) të lirohet i treti;
- 2.2.4 Pensionistët;
- 2.2.5 Personat me aftësi të kufizuar;
- 2.2.6 Organizatat që ofrojnë bashkëpunim të rregullt me Komunën e Gjakovës, me qytetarët për promovim të vlerave në dobi të përgjithshme.

2.3 Nga pagesa për shfrytëzimin e hapësirave në Pallatin e Kulturës “Asim Vokshi” lirohen:

- 2.3.1 Organizimet me karakter të ngushtë kulturor ku nënkuptojmë grupe të ndryshme që kanë ndërlidhje me aktivitetet në koherencë me Komunën e Gjakovës;

2.3.2 Institucionet tjera publike të cilat në bashkëpunim me Komunën organizojnë aktivitete në sferën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

2.3.3 Shoqatat e dala nga lufta, personat me nevoja të veçanta, shoqatat e personave me nevoja të veçanta dhe komuniteti fetar.

2.4 Nga pagesa për shfrytëzimin e Galerisë së Arteve lirohen:

2.4.1 Artistët profesionālë që me veprimtarinë e tyre kontribojnë në sferën e artit dhe kulturës përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme.

2.5 Nga pagesa e shfrytëzimit të Teatrit të Qytetit “Hadi Shehu” lirohen:

2.5.1 Teatrot simotra (teatrot e qyteteve), teatrot kombëtare, kompanitë teatrore të nivelit të njëjtë profesional lirohen nga pagesa;

2.5.2 Të hyrat si në pikën 2.5.1, 70% i marrin trupa mysafire ndërsa 30% mbesin në teatrin nikoqir.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në ueb faqen e komunës së Gjakovës.

Arbëneshja Kuqi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës

